

## Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



### Raport Mujor Nentor 2022

#### Informacion bazë

Administrimi i Fondit

Monedha

Vlera fillestare e kuotës

Shuma fillestare minimale

Shuma minimale pasuese

Komision në hyrje

Komision në dalje

Penalite ne rast terheqje te parakohshme

Komision Administrimi ne vit

Kosto per transferte fondesh nga pale te treta

**Shoqëria  
Raiffeisen Invest  
sh.a**

**LEK**

**1,000**

**1,000**

**1,000**

**0%**

**0%**

**Sipas rregullores  
se AMF-se**

**1.50%**

**Referojuni  
informacionit ne  
deget e RBAL**

#### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Vullnetar është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.

Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbërë kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).


#### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të larta



**Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me rrezik më të ulët.**


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 30.11.2022

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>1,197,951,987</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>3,530</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>2,044.0562</b>
<b>*Kthimi vjetor nga investimi (30.11.2021 - 30.11.2022)</b>	<b>4.03%</b>

\*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e portofolit të investimeve në 30 Nentor 2022



Ne kuader të politikës së investimit të fondit të Pensionit, investimet do të kryhen kryesisht në bono thesari dhe obligacione, të emetuara në tregun primar, duke patur parasysh që aktiviteti i tregtimit të titujve të borxhit të emtuar nga Qeveria shqiptare në treg sekondar është i kufizuar.

<i><b>Instrumenti</b></i>	<i><b>Ne % të Aseteve të Fondit</b></i>
Obligacione Thesari	97.55%
Depozita / Llogari rrjedhese	2.45%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuenca një here në 2 muaj për secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon të jetë e fokusuar në investime afatgjate.

Vlera neto e asetëve të fondit është rreth LEK 1.2 miliard në datë 30 Nentor 2022.

## Zhvillimet dhe ecuria e normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare gjatë muajit Nentor



Asetet e Fondit Pension janë të investuara në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këto arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve.

Investimet impaktohen kryesisht nga zhvillimet në tregun e brendshëm sic janë ndryshimet në normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare.

Pergjate muajit Nentor ne tregun vendas, normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare vazhduan te kene nje trend rrites, por rritja e normave ne pergjithesi ishte ne nivele me te uleta ne krahasim me muajt e meparshem. Yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 5.80% duke u rritur me 0.54% ne krahasim me ankandin e muajit Tetor, ndersa Bonot e Thesarit 3 dhe 6 mujore u rriten perkatesisht me 0.13% dhe 0.80%.

Per sa i perket obligacioneve, ankandi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 6.48%, duke u rritur me 1.58% krahasuar me ankandin paraardhes. Ankandi i obligacionit reference 5-vjeçar rezultoi ne 7.687%, duke u rritur me 1.41% krahasuar me ankandin e fundit. Ankandi i obligacionit 15-vjeçar rezultoi ne 8.95%, duke u rritur me 0.56% krahasuar me ankandin paraardhes.

Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Nentor 2021 – Nentor 2022. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Nentor.




## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Nentor 2022

**Kthimi vjetor neto i fondit është 4.03% per periudhen 30 Nentor 2021 – 30 Nentor 2022;**

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur nje trend rrites dhe vlera e kuotes eshte rritur me **+0.33%** gjate muajit Nentor. Kthimi vjetor eshte me i ulet karahasuar me vitet e meparshme sepse edhe normat e interesit te titujve te Qeverise, ne te cilat fondi investon, kane qene ne renie gjate viteve te fundit. Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise.

Rritja e normave të interesit të titujve të Qeverisë do të ndikojë pozitivisht në performancën e fondit të Pensionit, i cili mund të investojë me norma më të larta duke rritur kthyeshmerinë e portofolit të investimit në të ardhmen.

### Ecuria e çmimit të kuotës Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Ne 30 Nëntor 2022	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (31 Dhjetor 2010)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.03%	4.25%	4.29%	4.66%	5.20%	5.42%	6.18%

### Kthimi vjetor historik i Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen për çdo vit



Anetaret e fondit të Pensionit keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë qëndrimi në fond (mundësisht deri në moshën e pensionit, pese vjet para moshës së përcaktuar në Ligj) për të përfituar një kthim maksimal nga investimi, për të përmirësuar standartin e jetesës në moshën e pensionit dhe për të evituar penalitetet në rast tërheqje të parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitese e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a, në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al), ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.